

Përmbajtja

Faqe

Faqja Prezantuese	1
1. Hyrje	3
2. Analiza e problemit	4
3. Rezultatet e pritshme	5
4. Përfituesit e projektit	6
5. Metodologjia	6
6. Temat e trajnimit	8
A. Temat e trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve, programi parë	8
B. Temat e trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve, programi dytë	10
C. Temat e trajnimit me anëtarët KZAZ-ve, programi parë	11
D. Temat e trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve, programi dytë	12
E. Temat e trajnimit me trajnuesit e KQV-ve	13
F. Temat e trajnimit me anëtarët e KQV-ve	14
G. Temat e trajnimit me trajnuesit e GNV-ve	15
H. Temat e trajnimit me anëtarët e GNV-ve	16
7. Aspekte organizative	17
Struktura organizative dhe personeli i KQZ-së	17
Drejtoritë mbështetëse	17
8. Plani i punës dhe kalendari i veprimtarive	17
9. Monitorimi	20
10. Detaje Teknike	21
11. Risku i Projektit	25
12. Burimet financiare	25
13. Referencë	25

Bashkëlidhur strategjisë:

Lidhja 1: Përzgjedhja e trajnuesve të KZAZ, KQV-ve dhe GNV-ve;

Lidhja 2: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve;

Lidhja 3: Skema e Trajnimit të anëtarëve të KQV-ve, për çdo njësi administrative.

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

Titulli : Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015

Vendi : **KQZ, KZAZ, VNV, në njësi administrative**

Kohëzgjatja: **Janar 2015 – Qershor 2015**

Stafi realizues: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Sekretari i Përgjithshëm
Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit
dhe Edukimit të Zgjedhësve
Drejtoritë e tjera në KQZ

MISIONI I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE:

Rritja e nivelit profesional të komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve, për mbarëvajtjen e procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave, në funksion të realizimit të zgjedhjeve me standardet më të larta, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Shkurtime të përdorura në Strategji

KQZ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DKTZE Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve

ST Sektori i Trajnimeve

KZAZ Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor

KQV Komisioni i Qendrës së Votimit

GNV Grupi i Numërimit të Votave

Komisione zgjedhore - Komisione zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta (KZAZ, KQV, GNV)

KFV Kutia/kutitë me fletët e votimit

KMV Kutia e materialeve të votimit

Strategji - Strategjia e trajnimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015.

1. HYRJE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të nenit 21, pika 9 të Kodit Zgjedhor, ka detyrimin ligjor për zhvillimin e trajnimeve për anëtarët e komisioneve zgjedhore, KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në funksion të zbatimit të këtij detyrimi ligjor harton "Strategjinë e trajnimit të komisionerëve zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015".

Për të garantuar një proces zgjedhor të drejtë, korrekt e të paanshëm në përputhje me parimet e vendosura në Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore dhe standartet ndërkombëtare të kërkuara për zgjedhje demokratike, është mëse e nevojshme që strukturat e ngarkuara me ligj për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, të kualifikohen profesionalisht nëpërmjet intensifikimit dhe përmirësimit të trajnimeve përkatëse.

Qëllimi i strategjisë: *Përmbushja e detyrimit ligjor për trajnimin e komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve, rritja e profesionalizmit të tyre, si element thelbësor për mbarëvajtjen e procesit në zonën e administrimit zgjedhor, në qendrën e votimit dhe në vendin e numërimit të votave, në funksion të realizimit të zgjedhjeve me standartet më të larta, në përputhje me parimet dhe rregullat e vendosura në Kushtetutën dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve synon nëpërmjet zbatimit të strategjisë të përmirësojë cilësinë e trajnimeve, standardeve dhe programeve të trajnimeve bazike duke patur parasysh:

- ✓ rëndësinë e trajnimeve për komisionerët zgjedhorë, rritjen e profesionalizmit të tyre, si element thelbësor për standartet e procesit zgjedhor;
- ✓ në përmirësimin e metodikës së trajnimit, duke synuar bashkëpunimin dhe diskutimet e hapura mes trajnuesve dhe komisionerëve zgjedhorë;
- ✓ në zhvillimin e mëtejshëm të trajtimit të praktikave të gabuara të punës si mundësi për të mësuar, jo si raste ndëshkimi;
- ✓ në përcaktimin/shtimin e indikatorëve/njësive të matjes së cilësisë së trajnimit dhe zbatimi i situatave të trajtuara/aplikuara/demostruara në trajnim gjatë punës së komisionerëve zgjedhorë;
- ✓ në aftësimin dhe adaptimin me ndryshimet ligjore për të përcaktuar saktë situatat problematike, për t'i menaxhuar ato nëpërmjet vendimmarrjes së duhur e të shpejtë për të arritur një standard të lartë performance.
- ✓ zhvillimin dhe përmirësimin e platformës së trajnimit, rritjen e efencës së procesit të trajnimit jo vetëm për komisionerët zgjedhorë, por edhe për target grupe të ndryshme, dhe për të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në proces.

Marrja e përgjegjësisë nga komisionerët zgjedhorë, e gjithë veprimtaria e tyre në administrimin e procesit zgjedhor në ZAZ, QV dhe veçanërisht në VNV, do të ndihmonte realisht në vlerësimin e zgjedhjeve demokratike, të lira, të drejta dhe të pranuar nga të gjithë.

Konkretisht, programet dhe sesionet e trajnimit do të ofrojnë:

- Informimin dhe përvetësimin e njohurive mbi Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjorë të KQZ-së, të nxjerra për zbatimin e tij;
- Aftësimin e komisionerëve në aspektin praktik, për mënyrën e reagimit dhe veprimit në situata të caktuara, duke zbatuar korrektësisht procedurat ligjore;
- Qendrimin dhe sjelljen ligjore, zbatimin e kodit të sjelljes/etik, në çdo situatë probematike të krijuar në përputhje me legjislacionin zgjedhor.

Kjo strategji synon, nëpërmjet formave dhe mënyrave efikase dhe efçente, trajnimin e komisionerëve zgjedhorë, minimizimin e rasteve të komisionerëve të patrajnuar, të cilët duke u shfaqur me paaftësi teknike-profesionale si zyrtarë zgjedhorë, demostrojnë paaftësi dhe shkaktojnë vonesa dhe probleme në procesin zgjedhor.

Strategjia parashikon platformën dhe kornizën e plotë për rritjen e profesionaizmit të anëtarëve të KZAZ-ve, QV-ve dhe GNV-ve, si aktorë, që luajnë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e procesit. Zbatimi i saj do të bëhet nëpërmjet planit të veprimit, parashikuar në vijim, i cili është ndërtuar dhe do të realizohet mbi bazën e analizës dhe qasjes praktike të çdo faze ku kalon procesi zgjedhor në Zonën e Administrimit Zgjedhor (ZAZ), në Qendrën e Votimit (QV) dhe në Vendin e Numërimit të Votave (VNV), siç parashikohet në Kodin Zgjedhor dhe aktet e dala në zbatim të tij. Kjo strategji parashikon në mënyrë të detajuar të gjitha etapat ku do të kalojë procesi i trajnimit të komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve.

Platforma e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë për zgjedhjet vendore të datës 21.06.2015, reflekton dhe gjetjet e raporteve të vëzhgimit të organizatave ndërkombëtare dhe vendase për trajnimet e zgjedhjeve 2013, si dhe eksperiencën e përfutur të sesioneve të trajnimit për njohuri të përgjithshme dhe aspekte të veçanta të administrimit zgjedhor, të zhvilluara jashtë periudhës zgjedhore gjatë vitit 2014, për të gjithë të interesuarit.

2. ANALIZA E PROBLEMIT

ARRITJE, PROBLEME DHE NEVOJA

Procesi dhe dita e zgjedhjeve për Kuvendin të datës 23 qershor të vitit 2013 në tërësi ka qenë pa dyshim standardi më demokratik i realizuar nga administrata zgjedhore, ku rol të rëndësishëm në këtë proces zgjedhor ka edhe programi dhe niveli i realizimit të trajnimit.

Platforma e trajnimit dhe programet e trajnimit të organizuara nga KQZ në zgjedhjet e vitit 2013 u vlerësuan në mënyrë pozitive në Raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR, megjithë efektiviteti i tyre u vlerësua i kufizuar, për shkak të emërimeve të vonuara në komisionerëve.

Realizimi i trajnimeve me sukses u mundësua nga:

- Hartimi i strategjisë së trajnimit, konkrete, praktike e të zbatueshme bazuar në eksperiencën e mëparshme të KQZ-së në këtë fushë;
- Hartimi i manualeve të kuptueshme dhe praktike për trajnimet;
- Përzgjedhja e trajnuesve me aftësi trajnuese në përgjithësi dhe në fushën e zgjedhjeve në veçanti;
- Përgatitja e Guidës për trajnimin e trajnuesve të KQV-ve;

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

- Trajnimi me nivel të lartë profesional i trajnuesve (KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve);
- Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, me nivel të lartë profesional, teknik dhe praktik sipas skemës së trajnimit e cila ishte fleksibile e adaptueshme sipas situatave dhe nevojave;
- Përgatitja e logjistikës së trajnimit, të plotë, teknike dhe praktike sipas nevojës së planifikimit në strategji;
- Vlerësimi në dinamikë dhe sipas etapave për nivelin e realizimit të programeve trajnuese të zhvilluara me anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve.

Për të zbatuar strategjinë e trajnimit, proces mjaft i rëndësishëm ishte dhe përzgjedhja e trajnuesve, sipas kriterëve të përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke I dhënë përparësi kandidatëve me profesionin jurist, dhe rekrutimit të trajnuesve me eksperiencë.

Arritje e strategjisë së trajnimit në zgjedhjet e vitit 2013 ishte dhe realizimi i trajnimit të trajnerëve të KZAZ-ve (ToT) së bashku me IRZ. Si arritje në këto sesione trajnim ishte dhe trajtimi tematikave "Për teknikat e trajnuesit" dhe "Komunikimi dhe etika në komunikim" të cilat u mbështeten nga ekspertë të IFES dhe KiE.

Problematika që çënuan efektivitetin e trajnimeve:

- Partitë politike, nuk i paraqitën propozimet për anëtarë të KQV dhe GN në afatin e duhur ligjor, megjithë apelin e vazhdueshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Lirimet/emërimet e komisionerëve të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve edhe pas trajnimit të tyre nga KQZ;
- Zëvendësimi i anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve, sidomos ditën e zgjedhjeve, me komisionerë të pa trajnuar;
- Mosparaqitja e komisionerëve për t'u trajnuar në kohën dhe vendin e trajnimit;
- Trajnimi i komisionerëve nga vetë partitë politike;
- Anëtarët e KQV-ve dhe GNV-ve, gjatë zhvillimit të sesioneve të trajnimit, nuk pranorin të identifikoheshin duke mos nënshkruar në listën e pjesëmarrjes në trajnim;
- Mospjesëmarrja në trajnime, një arsye e mundshme për këtë është frika se mos të emëruar mund të korruptohen në favor të interesave të partive opozitare;

Problemet e sipërcituara, që çënojnë cilësinë dhe efikasitetin e trajnimit, evidente edhe në raportet përfundimtare të OSCE/ODIHR për zgjedhjet e mëparshme 2005,2007, 2009, 2011, 2013, dëshmojnë probleme të cilat gjenerohen nga veprime/qëndrime të partive politike, dhe nuk mund të gjejnë zgjidhje vetëm me angazhimin e KQZ-së.

3. REZULTATET E PRITSHME

Realizimi i këtij projekti, synon:

- Përzgjedhjen e trajnuesve me eksperiencë zgjedhore;
- Realizimin me cilësi dhe profesionalizëm programin e trajnimit të trajnerëve;
- Realizimin me cilësi dhe profesionalizëm programin e trajnimit me anëtarët e emëruar në KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të;

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

- Konsolidimin dhe ngritjen e kapacitetit të skuadrës së trajnuesve të KZAZ-ve;
- Rritjen e pjesëmarrjes së komisionerëve zgjedhorë, në programet e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja;
- Rritjen dhe përforcimin e njohurive mbi Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore në zbatim të tij, tek komisionerët zgjedhorë të të gjitha niveleve;
- Zbatimin me korrektësi të ligjit zgjedhor dhe procedurave ligjore, në ZAZ, QV dhe VNV, për plotësimin e standardeve zgjedhore;
- Zgjidhjen me profesionalizëm, paanshmëri, efektivitet nga ana e komisionerëve zgjedhorë të të gjitha niveleve (KZAZ, KQV, GNV), për çdo problematikë të krijuar gjatë ushtrimit të detyrës;
- Rritjen e standardeve për mirëadministrimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor;
- Zvogëlimin e numrit të ankimeve nga subjektet zgjedhore;
- Rritjen e besimit të zgjedhësve dhe të gjithë aktorëve të tjerë për mirëadministrimin e votës.

4. PËRFITUESIT

Përfitues të drejtëpërdrejtë janë:

- Komisionerët zgjedhorë (KZAZ, KQV, GNV) në funksion të menaxhimit dhe mirëadministrimit tërësor të procesit;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në funksion të përmbushjes të misionit dhe zbatimit të detyrimeve të tij ligjore kushtetuese.
- Zgjedhësit dhe aktorët zgjedhor (subjektet zgjedhore, kandidatët për kryetarë dhe këshilltarë bashkie);
- Trajnuesit e komisioneve të të gjitha niveleve (KZAZ, KQV, GNV-ve);

5. METODOLOGJIA

Metodologjia e trajnimeve bazohet në interaktivitetin e pjesëmarrësve, si kundër ka qenë edhe në zgjedhjet e mëparshme, sa e lehtë në të kuptuar, po aq tërheqëse për pjesëmarrësit në trajnim, dhe gjithëpërfshirëse. Kjo metodologji do të shërbejë në rritjen e njohurive zgjedhore, njohjen e mjeteve dhe dokumentacionit të punës së komisionerëve zgjedhorë, aftësimin dhe përvetësimin e tyre të cilat ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e procesit zgjedhor.

Në trajnime do të vijohet me eksperiencën në përgatitjeve të manualeve trajnuese, duke pasqyruar:

- detyrat kryesore të komisionerëve zgjedhorë;
- ndryshimet në Kodin Zgjedhor, Kodin Penal, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së;
- shembuj praktikë të cilët do të demonstrohen gjatë trajnimeve, por do të përfshihen në manuale;
- paraqitja e rasteve të vlefshmërisë së votës në manualin e GNV-së;
- procedurat për administrimin e "fletëve të votimit të hedhura gabim".

Manuali i KZAZ, do të jetë në dy pjesë, së bashku me fletoret e punës, përkatëse, pasi në zgjedhjet vendore, KZAZ-të kanë detyra të shtuara. Për këtë shkak anëtarët e KZAZ-ve do të trajnohen në dy programe.

Manualet dhe fletoret e punës do të përmbajnë:

- shembuj praktikë me ilustrime, skema e foto ilustruese të procedurave;

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

- paraqitje grafike, design;

Lidhur me problemet që duhet të zgjidhë dhe menaxhojë KQV dhe KZAZ-së ditën e zgjedhjeve do të trajtohen:

- shembuj/situatë, për mënyrën e zgjidhjes së tyre, veprimet ligjore dhe përdorimi i modeleve të punës e ndërthurur me vendimmarrjen e tyre, sipas detyrave përkatëse.
- ushtrime praktike në grupe të vogla, punë në grup;
- prezantime powerpoint;

Për trajnimin e trajnuesëve, në veçanti me trajnuesit e rinj do të përdoret edhe metodologji alternative:

- Guidë/ manual e/i trajnuesëve (metodologji e dhënies së leksioneve).

Metodologjia e trajnimit do të fokusohet në:

1. Dhënie e informacioneve, që shfaqen në videoprojektor. Gjatë dhënies së informacionit trajneri zgjeron informacionin nëpërmjet veprimeve praktike dhe për çdo pikë zhvillohen diskutime me pjesëmarrësit;

2. Simulimin praktik (demostrim) të proceseve, që zhvillohen në KZAZ dhe KQV, duke realizuar situatat ku kalon procesi zgjedhor, si dhe situata problematike, të hasura në praktikë në proceset zgjedhore të kaluara, me qëllim dhënie e udhëzimeve për zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve, gjatë procesit zgjedhor në funksion të mirëadministrimit të procesit;

3. Diskutime të rasteve problematike, që janë hasur gjatë zgjedhjeve nga vetë pjesëmarrësit me eksperiencë zgjedhore dhe udhëzime të trajnuesit për evitimin e këtyre situatave;

4. Ilustrim me foto;

5. Diskutime të hapura (shembuj nga rastet në zgjedhjet 2009, 2013, marrja e njëres nga vultat), votimi për të tretët (gruaja/nusja/vajza voton për burrin/vjehrrin/babain emigrant), zgjedhësi dhe lista e zgjedhësve, fleta e dëmtuar, fotografimi i votës, letër njoftimi/pasaporta pak e dëmtuar, pretekst për të bërë debat, trajtimi i rasteve të veçanta si personat e martuar, që nuk kanë ndryshuar mbiemrin në dokumentin e identifikimit, etj.

6. Njohja me Testet kualifikuese për KZAZ, KQV-të dhe GNV-të nëpërmjet shembujve;

7. Testimi.

Gjatë trajnimit, trajnuesit duhet të identifikojnë me profesionalizëm se cilat janë njohuritë dhe aftësitë që pjesëmarrësit zotërojnë, të tregohen fleksibël për realizimin e trajnimit bazuar në paqartësinë/problemin e evidentuar.

Zbatimi i metodologjisë së sipërcituar gjatë zhvillimit të programeve të trajnimit do të transmetojë, tek anëtarët e komisioneve të të gjitha niveleve: Optimizimin, bashkëpunimin, unitetin për gjetjen e zgjidhjeve, konsensusin, tolerancën, besimin, stimulimin e ideve, shuarjen e mosmarrëveshjeve, gjykimin "është çështje e të gjithëve", bashkëpunim e frytshëm, sipas standarteve të kërkuara. Pra, fokusi i trajnimit është në krijimin e aftësive, karaktereve, kompetencave, besueshmërisë dhe kurajos, aftësinë për të vënë në praktikë njohuritë dhe përvojat e marra gjatë këtij trajnimi.

Materialet didaktike, në funksion të metodologjisë:

- Flip chart;
- Videoprojektor;
- Kompjuter;
- Ilustrime me: foto, pamje filmike dhe diçitura për të shtuar efektin e ligjëratës, për të thyer monotoninë, për të praktikuar aftësitë për zgjidhjen e problemeve;
- Manuale: KZAZ, KQV, GNV me ilustrime (foto dhe figura me ngjyra për çdo procedurë);
- Fletore pune: KZAZ, KQV, GNV me modele dhe shembuj të plotësuar;
- Fletë adezive me modele të vlerësimit të votave "te vlefshme" dhe të "pavlefshme";
- CD, që përmbajnë:
 - leksionet e përgatitura nga lektorët për sesionet trajnuese;
 - modelet e dokumentacionit të punës, për procedurazgjedhore të caktuara në KZAZ, KQV, GNV si dhe modelet e dokumenteve të kandidimit, për trajnimin e komisionerëve në ato ZAZ, ku kandidatët do të depozitojnë kërkesat për kandidim për kryetarë dhe këshilltarë bashkie.

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

Programet trajnuese me komisionerët zgjedhorë të të gjitha niveleve do të ndihmohet e mbështetet nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të KQZ-së të materialeve trajnuese (mësimi on-line) dhe njoftimet për trajnimet sipas programeve.

KQZ sipas eksperiencës pozitive të zgjedhjeve të mëparshme do të realizojë njoftime në mjetet e informimit publik (media e shkruar dhe elektronike), për subjektet zgjedhore për kohën dhe kalendarin e zhvillimit të trajnimeve sipas skemës përkatëse.

Komisionerët do të trajnohen për procedurat e votimit të zgjedhësve PAK, mënyrën e përdorimit të mjeteve të posaçme të votimit nga kjo kategori zgjedhësish.

6. TEMATIKA E TRAJNIMEVE

A. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p><u>Programi parë</u></p> <ul style="list-style-type: none">- Roli i rëndësishëm i administratës zgjedhore për standardet e procesit zgjedhor;- Njohja me standardet, misionet e Vëzhgimit të Zgjedhjeve, rëndësia e shoqërisë civile në procesin zgjedhor;- Rëndësia e trajnimit zgjedhor, referencë Raporti OSBE-ODIHR;- Metodologjia e dhënies së leksioneve për të rritur efektivitetin e trajnimeve, teknika e trajnuesit, trajnimi,- Procesi i komunikimit, mënyrat e komunikimit, teknikat e të folurit, strategjia efektive e komunikimit, ndërtimi i raporteve.	

A.1. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p>Programi parë "Detyrat e KZAZ-së, deri në përgatitjen e Vendit të Numërimit të Votave"</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parime të përgjithshme nga Kodi Zgjedhor; - Kodi sjelljes/etikës, parime të sjelljes së komisionerit; - Bashkëpunimi me institucionet, partitë politike, median dhe vëzhguesit; - Ngritja, funksionimi/ detyrat dhe përgjegjësitë e KZAZ-së; - Kalendari i veprimeve të KZAZ-së, cikli zgjedhor; - Dokumentet e kandidimit, verifikimi i tyre dhe vendimmarrja për shpalljen e kandidatëve nga KZAZ-të (në ZAZ-të që kanë një KZAZ); - Zgjedhësi, ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, lista e zgjedhësve procedura/afate për të ushtruar të drejtën e votës; <p>Shembuj: (Njohja me modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja, Organizimi, funksionimi/detyrat dhe përgjegjësitë e KQV-ve; - Verifikimi i ambienteve të QV-ve të ngritura në ZAZ; - Caktimi i Grupeve të Numërimit dhe emërimi i anëtarëve të tyre; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së KZAZ-së; - Përgatitja e trajnuesve për testin kualifikues dhe testimi i tyre. 	

B. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të trajnuesve të KZAZ-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p>Programi dytë "Detyrat e KZAZ-së ditën e zgjedhjeve deri në përfundim të procesit zgjedhor në ZAZ"</p> <p>Dita e zgjedhjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e detyrave të anëtarëve të KZAZ-se për ditën e votimit; <p><u>Dita e votimit:</u> Raste studimore/problematike;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i situatave/problemeve dhe zgjidhja e konflikteve; - Dërgimi i informacionit në KQZ për pjesëmarrjen në zgjedhje; - Procedurat e marrjes në dorëzim të materialeve të votimit të sjella nga çdo KQV, në VNV; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit, Fletorja e punës së KZAZ-së; - Procedurat e dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KQZ- KZAZ- KQV; - Plotësimi i procesverbalit të marrjes në dorëzim të KFV dhe KMV; - Procedurat për fillimin e procesit të numërimit të votave; - Procedurat që ndiqen në VNV për personat e pranishëm (<i>personat e autorizuar personat që mbajnë akreditimin, numri i vëzhguesve</i>); - Trajtimi i ankesave në KZAZ dhe VNV (modeli i kërkesës); - Njohja me modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së <p>Detyrat dhe vendimmarrja e KZAZ-së në VNV</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrat dhe vendimmarrja e KZAZ-së në VNV, ndarja e detyrave të anëtarëve të GNV-se; - Radha e numërimit për zgjedhjet e pushtetit vendor, procesi i hapjes së KFV; - Procesi i hapjes së Kutisë me Fletët e Votimit (edhe rasti, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit edhe në KMV; - Procesi i hapjes së KMV, kur mungon Procesverbali i Mbylljes së së Votimit në KMV; -Pezullimi i numërimit dhe Plotësimi i Procesverbalit të Konstatimit, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit edhe në KMV; - Procesi i vlerësimit të votave, - Mbyllja e kutisë së votimit, - Veprimet përmblyëse. <p>Numërimi, Tabulimi i rezultatit, Rendësia e transmetimit të rezultateve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedura për administrimin, vlerësimin dhe numrimin e fletëve të hedhura gabim, zarfet me fletët e hedhura gabim, procesverbali i konstatimit për pasqyrimin e tyre dhe dorëzimi i tyre pranë KZAZ-së; - Detyrat e KZAZ-së për plotësimin e Tabelës Përmbledhëse Provizore; - Mënyra e plotësimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së; - Detyrat e Sekretarit të KZAZ-së, pas tabulimit të Tabelës së Rezultateve të QV-së nga GN*(trajnim i veçantë) Transmetimi elektronik i rezultateve. <p>Administrimi, transportimi dhe dorëzimi i dokumentacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së KZAZ-së, Fletorja e punës së KZAZ-së; - Përgjegjësitë dhe sanksionet e anëtarëve të KZAZ-së. <p>Shembuj: <i>Përgatitja e anëtarëve për testin kualifikues dhe testimi i tyre.</i></p>	<p>90 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

C. Temat e trajnimit, për programin e trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p><u>Programi parë</u></p> <p>“Detyrat e KZAZ-së, deri në përgatitjen e Vendit të Numërimit të Votave”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parime të përgjithshme nga Kodi Zgjedhor; - Kodi sjelljes/etikës, parime të sjelljes së komisionerit; - Rëndësia e trajnimit në procesin zgjedhor; - Bashkëpunimi me institucionet, partitë politike, median dhe vëzhguesit; - Ngritja, funksionimi/ detyrat dhe përgjegjësitë e KZAZ-së - Kalendari i veprimeve të KZAZ-së, cikli zgjedhor; - Dokumentet e kandidimit, verifikimi i tyre dhe vendimmarrja për shpalljen e kandidatëve nga KZAZ-të (në ZAZ-të që kanë një KZAZ) - Zgjedhësi, ekstrakti i përbërësve zgjedhorë, lista e zgjedhësve procedura/afate për të ushtruar të drejtën e votës; <p>Shembuj: (Njohja me modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së)</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngritja, Organizimi, funksionimi/detyrat dhe përgjegjësitë e KQV-ve; - Verifikimi i ambienteve të QV-ve të ngritura në ZAZ; - Caktimi i Grupeve të Numërimit dhe emërimi i anëtarëve të tyre; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së KZAZ-së; <p style="padding-left: 20px;">Fletorja e punës së KZAZ-së;</p> <p>Shembuj: <i>Përgatitja e anëtarëve për testin kualifikues dhe testimi i tyre.</i></p>	<p>90 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

D. Temat e trajnimit, për programin e trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p>Programi dytë "Detyrat e KZAZ-së ditën e zgjedhjeve deri në përfundim të procesit zgjedhor në ZAZ"</p> <p>Dita e zgjedhjeve - Ndarja e detyrave të anëtarëve të KZAZ-se për ditën e votimit; Dita e votimit: Raste studimore/problematike; - Menaxhimi i situatave/problemeve dhe zgjidhja e konflikteve; - Dërgimi i informacionit në KQZ për pjesëmarrjen në zgjedhje; - Procedurat e marrjes në dorëzim të materialeve të votimit të sjella nga çdo KQV, në VNV; - Procedurat e dorëzimit të materialeve zgjedhore nga KQZ- KZAZ- KQV; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit, Fletorja e punës së KZAZ-së; - Plotësimi i procesverbalit të marrjes në dorëzim të KfV dhe Kmv; - Procedurat për fillimin e procesit të numërimit të votave; - Procedurat që ndiqen në VNV për personat e pranishëm (<i>personat e autorizuar personat që mbajnë akreditimin, numri i vëzhguesve</i>); - Trajtimi i ankesave në KZAZ dhe VNV (modeli i kërkesës); - Njohja me modelet e dokumentacionit të punës së KZAZ-së</p> <p>Detyrat dhe vendimmarrja e KZAZ-së në VNV - Detyrat dhe vendimmarrja e KZAZ-së në VNV - Detyrat dhe vendimmarrja e KZAZ-së në VNV, ndarja e detyrave të anëtarëve të GNV-se; - Radha e numërimit për zgjedhjet e pushtetit vendor, procesi i hapjes së KfV; - Procesi i hapjes së Kutisë me Fletët e Votimit (edhe rasti, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit edhe në Kmv; - Procesi i hapjes së Kmv, kur mungon Procesverbali i Mbylljes së së Votimit në Kmv; -Pezullimi i numërimit dhe Plotësimi i Procesverbalit të Konstatimit, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit edhe në Kmv; - Procesi i vlerësimit të votave, - Mbyllja e kutisë së votimit, - Veprimet përmbyllëse.</p> <p>Numërimi, Tabulimi i rezultatit, Rendësia e transmetimit të rezultateve - Procedura për administrimin, vlerësimin dhe numrimin e fletëve të hedhura gabim, zarfet me fletët e hedhura gabim, procesverbali i konstatimit për pasqyrimin e tyre dhe dorëzimi i tyre pranë KZAZ-së; - Detyrat e KZAZ-së për plotësimin e Tabelës Përmbledhëse Provizore; - Mënyra e plotësimit të Tabelave Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së; - Detyrat e Sekretarit të KZAZ-së, pas tabulimit të Tabelës së Rezultateve të QV-së nga GN*(trajnim i veçantë) Transmetimi elektronik i rezultateve.</p> <p>Administrimi, transportimi dhe dorëzimi i dokumentacionit - Dërgimi i materialeve zgjedhore në KQZ; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së KZAZ-së, Fletorja e punës së KZAZ-së; - Pëgjegjësitë dhe sanksionet e anëtarëve të KZAZ-së.</p> <p>Shembuj: Përgatitja e anëtarëve të KZAZ-ve për testin kualifikues dhe testimi i tyre.</p>	<p>90 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

E. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të trajnuesve të KQV-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<ul style="list-style-type: none"> - Parime të përgjithshme të Kodit Zgjedhor; - Rëndësia e administratës zgjedhore; - Rëndësia e trajnimit, - Metodologjia e dhënies së leksioneve për të rritur efektivitetin e trajnimeve, teknika e trajnuesit, trajnimi zgjedhor; - Procesi i komunikimit, mënyrat e komunikimit, teknikat e të folurit, strategjia efektive komunikimi, ndërtimi i raporteve; - Kodi sjelljes/etikës, parime të sjelljes së komisionerit. <p>Parimet, procedurat dhe përdorimi i modeleve të punës së KQV-së</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përbërja, detyrat e anëtarëve të KQV-së, kryetarit dhe sekretarit; - Kodi etik, parime të sjelljes së komisionerit; - Mbledhjet dhe vendimmarrja e KQV-së; - Plotësimi i vendeve vakante në KQV; - Trajtimi i ankesave në KQV (modeli i kërkesës); - Njohja me modelet e të dokumentacionit të punës së KQV-së. <p>Përgatitja e Qendrës së votimit një ditë para datës së zgjedhjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurat e marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore, për votim në KZAZ; - Sistemimi i materialeve të votimit në QV; - Punonjësi i Policisë së Shtetit dhe detyrat e tij; <p>Hapja e QV - Procedurat para fillimit të votimit; Procedurat e votimit dhe mbyllja e tij</p> <ul style="list-style-type: none"> - Respektimi i procedurave të votimit; - Procedurat e votimit dhe rregullat për ndihmën e personave që nuk mund të votojnë vetë dhe PAK; - Regjistri i posaçëm; - Procedurat para dhe pas mbylljes së votimit; - Plotësimi i procesverbalit të mbylljes së votimit; - Procedura për dorëzimin e bazës materialeve të votimit në KZAZ, në VNV; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës, fletorja e punës së KQV-së; - Plotësimi i procesverbalit të marrjes në dorëzim të KFV dhe KMV; - Dërgimi i informacionit në KZAZ; - Akreditimi dhe Vëzhguesit; - Përgjegjësitë dhe sanksionet e anëtarëve të KQV-së. <p>Shembuj të sjellë edhe nga vetë komisionerët gjatë zgjedhjeve të kaluara: Dita e votimit, raste studimore/problematike (psh. pezullimi i votimit, etj); Menaxhimi i i situatave/problemeve dhe zgjidhja e tyre; <i>Përgatitja e trajnuesve të KQV-ve me Testin kualifikues dhe testimi i tyre.</i></p>	<p>20 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

F. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të anëtarëve të KQV-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p>Parimet, procedurat dhe përdorimi i modeleve të punës së KQV-së</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përbërja, detyrat e anëtarëve të KQV-së, kryetarit dhe sekretarit; - Kodi etik, parime të sjelljes së komisionerit; - Mbledhjet dhe vendimmarrja e KQV-së; - Plotësimi i vendeve vakante në KQV; - Trajtimi i ankesave në KQV (modeli i kërkesës) - Njohja me modelet e të dokumentacionit të punës së KQV-së. <p>Përgatitja e Qendrës së votimit një ditë para datës së zgjedhjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedurat e marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore, për votim në KZAZ; - Sistemimi i materialeve të votimit në QV; - Punonjësi i Policisë së Shtetit dhe detyrat e tij; <p>Hapja e QV -Procedurat e fillimit të votimit; Procedurat e votimit dhe mbyllja e tij</p> <ul style="list-style-type: none"> - Respektimi i procedurave të votimit; - Procedurat e votimit dhe rregullat për ndihmën e personave që nuk mund të votojnë vetë dhe PAK; - Regjistri i posaçëm; - Procedurat para dhe pas mbylljes së votimit; - Plotësimi i procesverbalit të mbylljes së votimit; - Procedura për dorëzimin e bazës materialeve të votimit në KZAZ, në VNV; - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës, fletorja e punës së KQV-së; - Veprime të KZAZ-së gjatë verifikimit të kutisë së fletëve të votimit (KFV) dhe kutisë së materialeve të votimit (KMV); - Plotësimi i procesverbalit të marrjes në dorëzim të KFV dhe KMV; - Dërgimi i informacionit në KZAZ; - Akreditimi dhe Vëzhguesit; - Pëgjegjësitë dhe sanksionet e anëtarëve të KQV-së. <p>3.Shembuj të sjellë nga vetë komisionerët gjatë zgjedhjeve të kaluara:</p> <p>Dita e votimit: Raste studimore/problematike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i situatave problematike dhe zgjidhja e konflikteve. <p><i>Përgatitja e anëtarëve të KQV-ve me Testin kualifikues dhe testimi i tyre.</i></p>	<p>20 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

G. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të trajnuesve të GNV-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<ul style="list-style-type: none"> - Kodi etik, parime të sjelljes së anëtarit të GNV-ve, rregulli dhe qetësia në VNV; - Parimet e punës së GNV-ve, detyrat e anëtarëve të GNV-ve - Veprimtaria e anëtarëve të GNV në procesin e numërimit të fletëve të votimit: - Detyrat e anëtarëve të GNV-ve - Procedurat për fillimin e procesit të numërimit të votave; - Procesi i hapjes së Kutisë me Fletët e Votimit, dhe pas hapjes së KFV, nxjerrja e Procesverbalit të Mbylljes së Votimit; - Procedurat e numërimit të votave dhe procesi vlerësimit të fletëve të votimit; - Rastet kur KFV dhe KMV janë të parregullta; - Procesi i hapjes së KMV, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit në KMV; - Vendimmarrja e KZAZ-së në VNV; - Trajtimi i ankesave në VNV (modeli i kërkesës); - Procesi i vlerësimit të votave (kur vota është e vlefshme apo e pavlefshme); - Administrimi i fletëve të votimit pas numërimit të tyre; - Mbyllja e kutisë së votimit, veprimet përmbyllëse; - Nxjerrja e rezultatit për çdo QV nga GNV-ja; - Mënyra e plotësimit të tabelave të rezultateve nga GNV për çdo QV; <p>NUMËRIMI, TABULIMI I REZULTATIT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedura e veprimeve të GNV-së për numrimin e fletëve të hedhura gabim, procesverbali i konstatimit, zarfat me votat e hedhura gabim për secilin organ; - Detyrat e KZAZ-së për plotësimin e Tabelës Përmbledhëse Provizore; - Detyrat e Sekretarit të KZAZ-së, pas tabulimit të Tabelës së Rezultateve të QV-së nga GN*(trajnim i veçantë); - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së GNV-së, Fletorja e punës së GNV-së; - Vëzhguesit; - Mbyllja e kutisë së votimit , veprimet përmbyllëse; - Përgatitja për Testin kualifikues për trajnuesit e GNV-ve dhe testimi i tyre. 	<p align="center">12 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

H. Temat e trajnimit për programin e trajnimit të anëtarëve të GNV-ve

TEMAT QË DO TË TRAJTOHEN	KOHA
<p>Kodi etik, parime të sjelljes së anëtarit të GNV-ve, rregulli dhe qetësia në VNV;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parimet e punës së GNV-ve, detyrat e anëtarëve të GNV-ve - Veprimtaria e anëtarëve të GNV në procesin e numërimit të fletëve të votimit; - Detyrat e anëtarëve të GNV-ve - Procedurat për fillimin e procesit të numërimit të votave; - Procesi i hapjes së Kutisë me Fletët e Votimit, dhe pas hapjes së KfV, nxjerrja e Procesverbalit të Mbylljes së Votimit; - Procedurat e numërimit të votave dhe procesi vlerësimit të fletëve të votimit; - Rastet kur KfV dhe KfV janë të parregullta; - Procesi i hapjes së KfV, kur mungon Procesverbali i mbylljes së votimit në KfV; - Vendimmarrja e KZAZ-së në VNV; - Trajtimi i ankesave në VNV (modeli i kërkesës); - Procesi i vlerësimit të votave (kur vota është e vlefshme apo e pavlefshme); - Administrimi i fletëve të votimit pas numërimit të tyre; - Mbyllja e kutisë së votimit, veprimet përmbyllëse; - Nxjerrja e rezultatit për çdo QV nga GNV-ja; - Mënyra e plotësimit të tabelave të rezultateve nga GNV për çdo QV; <p>NUMËRIMI, TABULIMI I REZULTATIT</p> <ul style="list-style-type: none"> - Procedura e veprimeve të GNV-së për numrimin e fletëve të hedhura gabim, procesverbali i konstatimit, zarfat me votat e hedhura gabim për secilin organ; - Detyrat e KZAZ-së për plotësimin e Tabelës Përmbledhëse Provizore; - Detyrat e Sekretarit të KZAZ-së, pas tabulimit të Tabelës së Rezultateve të QV-së nga GN*(trajnim i veçantë); - Përdorimi i modeleve të dokumentacionit të punës së GNV-së, Fletorja e punës së GNV-së; - Vëzhguesit; - Mbyllja e kutisë së votimit , veprimet përmbyllëse; 	<p>10 ditë para datës së zgjedhjeve</p>

7. ASPEKTE ORGANIZATIVE

Struktura Organizative dhe Personeli

Zbatimi i strategjisë së trajnimit, do të mbikëqyret nga KQZ-ja.

Drejtorja e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, do të ndjekë dhe përgjigjet për përgatitjen, organizimin, mbarëvajtjen dhe monitorimin të programit të trajnimit në të gjithë komponentët që e shoqërojnë atë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore është koordinatore e projektit, e cila në bashkëpunim me Përgjegjësen e Sektorit të Trajnimit do të ndjekin:

- Programin e trajnimit dhe strategjinë për zbatimin e tij;
- Procedurën e përzgjedhjes së trajnuesve;
- Materialet që do të përfshihen në trajnim, të cilat do të miratohen më pas nga KQZ;
- Përgatitjen e terrenit dhe infrastrukturën në funksion të organizimit dhe realizimit të programit të trajnimit me të gjithë elementët teknikë, që e shoqërojnë atë;
- Monitorimin dhe vlerësimin në të gjitha nivelet e programit trajnues, që do zhvillohet;
- Informojnë, relatojnë në KQZ-së mbi realizimin e programit të trajnimit të zhvilluar dhe pjesëmarrjen e komisionerëve të çdo niveli (pas përfundimit të trajnimit).

Në përfundim, DKZTEZ/ST do të bëjë analizë të realizimit të programeve/sesioneve të trajnimit, bazuar në rezultatet e monitorimit, dhe raportet e trajnerëve.

Personeli i angazhuar, për realizimin e strategjisë do të jetë: Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, Drejtori i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, Përgjegjësjja e Sektorit të Trajnimit, DKZTEZ, Inspektori i Trajnimit, specialistët e DKZTEZ, Sektori i Edukimit të Zgjedhësve, Inspektorët Rajonalë Zgjedhor, DBNJ.

Drejtoritë mbështetëse

Realizimin e kësaj Strategjie, si edhe koordinimin dhe mbarëvajtjen tërësore të procesit zgjedhor, do ta mbështesin sipas detyrave të tyre funksionale: Drejtoria Juridike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Logjistikës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtoria e Financës.

8. PLANI I PUNËS DHE KALENDARI I VEPRIMTARIVE

Në këtë plan të punës janë paraqitur prioritetet e punës së DKZTEZ/Sektorit të Trajnimit dhe përmbledhja e aktiviteteve të planifikuara për realizimin e strategjisë së trajnimit për zgjedhjet e datës 21 qershor 2015.

Kalendari i veprimtarive

NR	VEPRIMTARITË	PËRGJEGJËSI	AFATI
1	Njoftimi (në web, median elektronike, për afatin kohor të dorëzimit të dokumentacionit dhe vendin e zhvillimit të intervistës për përzgjedhjen e trajnuesve (KZAZ, KQV, GNV)	DKZTEZ/ST/DTI/DBNJ DShLogj	Jo më vonë se 23 janar
2	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit të KZAZ, dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 06 shkurt

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

3	Intervista e trajnuesve	DKZTEZ/ST/ DBNJ	Jo më vonë se 15 shkurt
4	Përzgjedhja trajnuesve	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 21 shkurt
5	Vendimmarrja për miratimin e trajnuesve	SEK.PERGJITHSHEM	
6	Njoftimi në web i listës së trajnuesve të përzgjedhur/miratuar (KZAZ,KQV,GNV)	DKZTEZ/ST/DBNJ	Jo më vonë se 25 shkurt
7	Prodhimi i Manualit të KZAZ-së, dhe Fletores së punës	Prokurimet	Jo më vonë se 16 mars
8	Përgatitja e programit të parë trajnues sipas temave përcaktuara në këtë strategji dhe logjistika për të	ST	Jo më vonë se 16 mars
9	Trajnimi i trajnuesve të KZAZ-ve Testimi i tyre	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 19 mars
10	Njoftimi i subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, inspektorëve rajonalë lidhur me kalendarin trajnues, pjesëmarrjen dhe vendin e zhvillimit të programit të parë të trajnimit me anëtarët e KZAZ-ve Njoftimi në median elektronike	DKZTEZ/ST/DShLogj	Jo më vonë se 15 mars
11	Trajnimi i parë i anëtarëve të KZAZ-ve	Trajnuesit/ST	Jo më vonë se 21 mars
12	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit të KZAZ, pjesa e dytë dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 21 prill
13	Prodhimi i Manualit të KZAZ-së, pjesa e dytë dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	Prokurimet	Jo më vonë se 16 maj
14	Përgatitja e programit të dytë trajnues, sipas temave përcaktuara në strategji dhe logjistika për të	ST	Jo më vonë se 16 maj
15	Trajnimi i dytë i trajnuesve të KZAZ-ve	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 25 maj
16	Njoftimi i subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, inspektorëve rajonalë lidhur me kalendarin trajnues, pjesëmarrjen dhe vendin e zhvillimit të programit të parë të trajnimit me anëtarët e KZAZ-ve Njoftimi në median elektronike	DKZTEZ/ST	Jo më vonë se 16 maj
17	Trajnimi i dytë i anëtarëve të KZAZ-ve	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 27 maj
18	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit të KQV-së dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 6 prill
19	Prodhimi i Manualit të KQV-së	Prokurimet	Jo më vonë se 7 maj
20	Përgatitja e programit trajnues me anëtarët e KQV -ve, sipas temave të përcaktuara në strategji dhe logjistika për të	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 16 maj
21	Njoftimi subjekteve zgjedhore, KZAZ-ve, prefekturave, inspektorëve rajonalë sipas skemës së trajnimit, në lidhje me pjesëmarrjen në trajnim të anëtarëve të KQV-ve, kalendarin trajnues dhe vendin e trajnimit të tyre. Njoftimi në median e shkruar dhe elektronike	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 18 maj
22	Trajnimi i trajnuesve të KQV-ve, në Tiranë, sipas programit dhe tematikës, që do trajtohet edhe në programin trajnues me anëtarët e KQV-ve	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 28 maj -3 qershor

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

23	Trajnimi i anëtarëve të KQV-ve	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 5-10 qershor
24	Hartimi, përgatitja dhe Miratimi i Manualit trajnues për grupet e numërimit të votave dhe Fletores së punës (me modele dhe fletë për shënime)	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 21 prill
25	Prodhimi i Manualit të GNV-së		Jo më vonë se 23 maj
26	Përgatitja e programit trajnues, me anëtarët e GNV sipas temave të përcaktuara në strategji dhe logjistika për të	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 8 qershor
27	Njoftimi në median e shkuar dhe elektronike, për afatin kohor, orarin dhe vendin e zhvillimit të trajnimit me anëtarët e GNV-ve	DKZTEZ/ST/	Jo më vonë se 7 qershor
28	Trajnimi i trajnuesve të GNV-ve në KQZ nga stafi i saj, sipas programit dhe tematikës që do trajtohet në programin trajnues me anëtarët e GNV-ve	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 12 qershor
29	Trajnimi i anëtarëve të Grupeve të Numërimit në Vendin e Numërimit të Votave, sipas programit dhe tematikës së përcaktuar në projekt dhe logjistika për të (në këtë trajnim të marrin pjesë edhe anëtarët e KZAZ-ve)	Trajnuesit	Menjëherë pas emërimit të tyre, (Jo më vonë se 11 qershor)
30	Trajnimi i veçantë i sekretarëve të KZAZ-ve, në seanca 3 orëshe	DKZTEZ/ST/DTI	Jo më vonë se 19 qershor
31	Takim në Tiranë me trajnuesit KZAZ-ve dhe ndihmësinspektorët rajonalë; <ul style="list-style-type: none"> • Dorëzimi në KQZ i materialeve trajnuese apo dokumenteve zgjedhore nga trajnuesit e KZAZ-ve; • Vlerësimi i trajnimit, dorëzimi i raporteve, komente, analiza lidhur me përmirësimin dhe modifikimin e metodave të përdorura për programet trajnuese në të ardhmen. • Hartimi i raportit/relacionit mbi realizimin përfundimtar mbi programin trajnues 	DKZTEZ/ST	Pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve

Për çdo manual, para miratimit të tij, duhet të miratohen një set/sërë aktesh, sipas temave të përcaktuara në strategji.

Për çdo trajnim,

- Sensibilizimi i subjekteve zgjedhore në median elektronike nga ana e KQZ-së, për rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e trajnimit;
- Përgatitja e logjistikës trajnuese për zhvillimin e programit trajnues me anëtarët e KQV-ve në koordinim me Zyrat Rajonale Zgjedhore;
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit (Drejtoritë Arsimore Rajonale në qarqe) për vënien dhe gadishmërinë e ambienteve shkollore në dispozicion të realizimit të trajnimeve;
- Koordinimi me ofruesin e shërbimit për transportimin e bazës materiale trajnuese në njësitë vendore/njësitë administrative;
- Monitorimi i trajnimit të anëtarëve të KZAZ-ve nga KQZ-ja, DKZTEZ dhe Inspektorët Rajonalë Zgjedhor;
- Raportimi/Relacioni mbi realizimin e programit të trajnimit për Anëtarët e KQZ-së.

9. MONITORIMI

Monitorimi i realizimit, ecurisë, cilësisë, efektivitetit, dobisë, standardit dhe transparencës së programit të trajnimeve do të kryhet nga:

- KQZ-ja, anëtarët dhe administrata e insitucionit: Sekretari i Përgjithshëm, DKZTEZ, ST, DBNJ dhe Inspektorët Rajonalë zgjedhorë;
- Aktorët pjesëmarrës në zgjedhje (politik dhe jopolitik);
- Misionet e vëzhguesve vendas dhe të huaj të akredituar nga KQZ-ja;
- Trajnuesit e kontraktuar nga KQZ-ja;
- Vetë përfituesit e drejtëpërdrejtë nga trajnimet (Anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve)

Monitorimi dhe vlerësimi nga KQZ-ja:

Për një gjykim sa më objektiv të suksesit të programit, si njësi matëse për vlerësimin do të shërbenin elementët tregues që shoqërojnë projektin në tërësi, si:

- Respektimi i procedurave të përzgjedhjes së trajnuesve sipas afateve kohore dhe planifikimit;
- Niveli dhe performanca e realizimit të programit të trajnimeve nga stafi i DKZTEZ/ST dhe drejtoritë e tjera bashkëpunuese në këtë program trajnimi;
- Niveli dhe performanca e realizimit të programit të trajnimeve nga trajnuesit sipas programeve për (KZAZ-të, KQV-të, GNV-të);
- Pjesëmarrja e komisionerëve zgjedhorë në trajnime dhe krahasimi i numrit të anëtarëve të KZAZ, KQV dhe GNV të trajnuar në vite;
- Niveli i njohurive të anëtarëve të KZAZ-ve të marra gjatë procesit të trajnimit (*i reflektuar nga rezultati i testimit të tyre kualifikues, si edhe nga veprimtaria korrekte dhe ligjore e ndjekur nga KZAZ-të, KQV-të dhe GNV-të*);
- Pakësimi në përqindje i kundërshtimeve dhe minimizimi i incidenteve në ZAZ, QV dhe VNV;
- Pakësimi i numrit të ankesave kundër vendimeve të KZAZ-së (raporti 2009-2013), i cili do të jetë një tregues i profesionalizmit dhe paanësisë së komisionerëve;
- Raportet për monitorimin e zgjedhjeve.

Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve do të ndjekë, monitorojë në terren si dhe do të vlerësojë të gjithë programet e trajnimeve sipas etapave.

DKZTEZ do të raportojë me informacione operative dhe rregullisht në KQZ mbi ecurinë dhe zbatimin e strategjisë, si edhe rezultatet e saj në lidhje me të gjitha fazat që kalon procesi i trajnimit.

Aktorët pjesëmarrës në zgjedhje

Programi i trajnimit mund të ndiqet, monitorohet dhe vlerësohet edhe nga aktorët pjesëmarrës në procesin zgjedhor.

Realizimi publikisht dhe me transparencë i trajnimeve ju garanton aktorëve të ndjekin se si zbatohet dhe realizohet programi i trajnimit sipas skemës të miratuar nga KQZ dhe e bërë publike.

Transparenca gjatë realizimit të programeve/sesioneve të trajnimit do të ndikojnë në rritjen e

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

besueshmërisë të aktorëve, me rol të drejtpërdrejtë ose jo në procesin zgjedhor, ndaj cilësisë së trajnimeve, në funksion të rritjes së pjesëmarrjes së komisionerëve në trajnime.

- **Misionet e vëzhguesve vendas dhe të huaj të akredituar nga KQZ-ja;**

Sipas të drejtave qytetare procesi i trajnimeve do të monitorohet e vlerësohet jo vetëm nga monitorues e koalicione vendase, por dhe vëzhgues të huaj të akredituar nga ana e KQZ-së.

Sipas praktikës dhe eksperiencave të mëparshme zgjedhore këto grupe monitorimi publikojnë dhe prezantojnë raportet e tyre sipas etapave që kalon procesi zgjedhor dhe në përfundim të tij.

Në këtë kontekst mendimet, sugjerimet, vlerësimet dhe rekomandimet e tyre do të merren në konsideratë në funksion të përmirësimit dhe ngritjes së performancës të realizimit të trajnimeve në etapat pasardhëse, por edhe për punën e KQZ-së në të ardhmen.

- **Trajnuesit e kontraktuar nga KQZ**

Sipas termave dhe detyrimeve kontraktuale, trajnuesit do të raportojnë gjatë ditës së trajnimit, në përfundim të ditës së trajnimit dhe në përmbyllje të procesit zgjedhor, si dhe do të administrojnë listë prezencat e pjesëmarrësve në trajnim.

Trajnuesit pas çdo programi trajnimi do të përgatisin raporte me të dhëna për ecurinë e trajnimit, pjesëmarrjen, organizimin, mbështetjen teknike dhe logjistike që do japë KQZ, mbështetjen dhe bashkëpunimin ndëraktiv që demostrojnë institucionet vendore, që kanë detyrim ligjor kontribues për zgjedhjet.

Këto raporte, të shoqëruara me listat e pjesëmarrjes në trajnim të nënshkruara nga komisionerët, do të administrohen nga stafi DKZTEZ/ST në funksion të krijimit të bazës së të dhënave për komisionerët zgjedhorë, si dhe për evidentimin e problematikave me të cilat janë përballur trajnuesit në punën e tyre.

- **Vetë përfituesit e drejtpërdrejtë nga trajnimet (Anëtarët e KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve)**

Vlerësimi nga përfituesit në trajnime-komisionerët zgjedhorë do të jenë pjesë integrale dhe kontribuese.

Pjesë e përgatitjes së raporteve vlerësuese të ecurisë dhe realizimit të trajnimeve do të jetë dhe pjesa e vlerësimit nga vetë pjesëmarrësit në trajnime/komisionerët zgjedhorë nëpërmjet formës së vlerësimit që do të realizohet në përfundim të çdo sesioni trajnimi dhe çdo ditë.

10 . DETAJE TEKNIKE

Nisur nga eksperiencia dhe rezultatet pozitive të realizimit të trajnimeve në zgjedhjeve për Kuvendin 2013 edhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015 është menduar që të bëhet me të njëjtën mënyrë organizimi.

Është planifikuar që trajnimi i trajnuesve të komisionerëve zgjedhorë (KZAZ, KQV, GNV) të realizohet në Tiranë.

Argumenti:

- KQZ menaxhon/monitoron dhe vlerëson efektivitetin dhe cilësinë e realizimit të trajnimit;
- Stafi i KQZ-së ndjek dhe vlerëson nga afër realizimin e trajnimit;
- Shtohet përgjegjësia e trajnuesve ndaj detyrimit për të marrë pjesë në trajnim;
- Vlerësim më real e objektiv i aftësive të trajnuesve.

Trajnimi i KZAZ-ve

Trajnimi i trajnuesve të KZAZ-ve

Programi i parë i trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve 52 trajnues të KZAZ-ve do të zhvillohet në Tiranë, një kohëzgjatje 2 ditore (2 grupe nga 2 ditë).

Në përfundim të trajnimit trajnuesit do t'i nënshtrohen procedurës së testimit të organizuar nga KQZ. Trajnuesit do të pajisen me certifikatën përkatëse si trajnues i KZAZ-ve.

Programi i dytë i trajnimit me trajnuesit e KZAZ-ve do të zhvillohet në një kohëzgjatje 1 (një) ditore (2 grupe nga 1ditë).

Për realizimin e trajnimit secili trajnues do të ketë materialet e nevojshme trajnuese në dosjen e tij vetjake. (Prezantim në poëerpoint, Kod zgjedhor, manual trajnimi, Fleepchart, Axxhendë trajnimi, formular konfirmimi të pjesëmarrjes së anëtarëve të KZAZ-ve në trajnim, udhëzime dhe vendime të KQZ-së, modele të nevojshme për punën e KZAZ-së (ilustruese), Test (zyrtar) për procedurën e testimit të KZAZ-ve, formular për procedurën e testimit, model raportimi të trajnuesit për trajnimin, etj.)

Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-ve

Trajnimi i anëtarëve të KZAZ-së do të zhvillohet në dy ditë (një ditë trajnimi për secilin program) nga trajnuesit e KZAZ-ve, ku secili prej tyre do të zhvillojë dy sesione trajnimi në ditë.

(Lidhja nr. 2)

Në rast se trajnuesi mungon, trajnimi është i detyrueshëm do të zhvillohet nga trajnuesi rezervë ose Inspektori Rajonal Zgjedhor ose DKZTEZ/ST.

Programet e trajnimit, do të zhvillohen në sallat e mbledhjeve të organeve të qeverisjes vendore, prefekturave, nënprefekturave, qarqeve, shkollave, etj.

Anëtarët e KZAZ-ve, pjesëmarrës në programin e parë të trajnimit do t'i nënshtrohen testimit, sipas materialit të përcaktuar në "Testin e organizuar nga KQZ". Testimi i tyre do zhvillohet pas përfundimit të trajnimit të programit të parë. Testimi do të realizohet në prezencën e IRZ, i cili do të konfirmojë procedurën e zhvillimit të testimit me nënshkrimin e tij. DKZTEZ/ST do të përgatisë procedurën dhe procesverbalin Tip.

Nëse rezultatet e testimit janë pozitive, një periudhë të mëvonshme ata do të pajisen me dëshminë përkatëse të trajnimit. Procedura të njëjta testimi do të ndiqen edhe në programet trajnuese në vazhdim, nëse do të ketë mungesë pjesëmarrje të anëtarëve të KZAZ-ve në programin e parë të trajnimit. Në të gjitha rastet vetëm komisionerët e trajnuar dhe të vlerësuar pozitivisht për testin e kryer do të pajisen me dëshminë e trajnimit dhe do mund të kryejnë detyrën e anëtarit të KZAZ-së.

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**

Është planifikuar në strategji, por dhe nisur nga eksperiencia pozitive të zgjedhjeve të mëparshme që në një ditë të veçantë do të trajnohen sekretarët e KZAZ-ve në KQZ, lidhur me detyrat e tyre të veçanta, si transmetimi i të dhënave (një seancë 3 orë). Ky trajnim të organizohet në bashkëpunim me DTI, sipas një grafiku të caktuar.

Për realizimin e trajnimit secili trajnues do të ketë materialet e nevojshme trajnuese sipas numrit të anëtarëve të KZAZ-ve që do të trajnojnë. Çdo anëtar i KZAZ-ve do të ketë dosjen/setin vetjak me materiale trajnuese.

Trajnimit i KQV-ve

Trajnimit i trajnuesve të KQV-ve

Programi i trajnimit me trajnuesit e KQV-ve (280 trajnues) do të zhvillohet në Tiranë nisur nga eksperiencia pozitive e zgjedhjeve për Kuvendin të vitit 2013. Për shkak të numrit të madh të trajnuesve të KQV-ve, ata do të ndahen në 7 grupe dhe si rrjedhojë kohëzgjatja e trajnimit të trajnuesve të KQV-ve do të shtrihet dhe zgjasë një javë të plotë.

Trajnimit i anëtarëve të KQV-ve

Trajnimit i anëtarëve të KQV-ve do të zhvillohet në një ditë nga trajnuesit e KQV-ve. Çdo trajnues do të kryejë 6 ditë trajnim.

Një ditë para ditës së zgjedhjeve për kryetarin, sekretarin e KQV-së do të zhvillohet Trajnimi specifik i tyre pasi përgjegjësia për shkak edhe të vetë pozicionit është të sigurojnë çdo veprim gjatë procesit zgjedhor të jetë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore (Kjo seancë do të zhvillohet nga një pjesë e trajnuesve, që do të angazhohen edhe për të trajnuar anëtarë të KZAZ-ve dhe KQV-ve, në rastet e zëvendësimit të tyre ditën e zgjedhjeve).

Anëtarët e KQV-ve, pjesëmarrës në programin e trajnimit do t'i nënshtrohen procedurës së testimit, sipas materialit, që përfshihet në "Testin e organizuar nga KQZ". Testimi i tyre do zhvillohet në seancën e mbasditës të programit të trajnimit. Programi i trajnimit me anëtarët e KQV-ve, do të zhvillohet në çdo njësi vendore dhe administrative. Vendi i trajnimit do të jetë kryesisht ambient arsimor ose social kulturor, sa më afër vendndodhjes së KZAZ-së, në varësi nga numri i QV-ve. Secili trajnues i KQV-ve do të zhvillojë programin e trajnimit sipas axhendës dhe sipas një skemë të detajuar nga KQZ-ja, e cila do t'i jepet në dispozicion në kohën e duhur. Në skemën paraprake është planifikuar që secili trajnues të trajnojnë 3 (tre) KQV në ditë.

Në fillim të çdo sesioni trajnues, komisionerëve të këtij niveli, do t'u shpërndahet manuali trajnues, fletore pune të KQV-ve, postera, fletë palosje..etj. dhe materiale të nevojshme për zhvillimin e tij. Seanca trajnuese do t'i referohet temës përkatëse, veprimeve procedurale, të ilustruara këto me improvizime praktike të procedurave, ku kalon procesi i votimit në QV. Problemeve të ditës së votimit dhe menaxhimi i situatave.

Në rast të mungesës së anëtarëve të KQV-së, gjatë zhvillimit të sesionit trajnues, Inspektori i Zyrës Rajonale Zgjedhore dhe vetë Trajnuesi, duhet të njoftojë KZAZ-në përkatëse dhe ST/DKZTEZ.

Nëse këta anëtarë do të mungojnë (dy ditë resht) edhe gjatë ditëve në vazhdim të zhvillimit të programit trajnues, atëherë KZAZ-ja do të njoftojë partitë politike përkatëse për të sjellë propozime të reja, me të cilët do të zhvillohet program i veçantë trajnimit.

(Lidhja nr. 3)

Trajnuesit ditën e zgjedhjeve do të angazhohen për të trajnuar anëtarë të KZAZ-ve dhe GNV-ve, në rastet e zëvendësimit të tyre. Ndërsa trajnimi i anëtarëve të KQV-së do të bëhet për aq sa është e mundur nga trajnuesi dhe /ose nga sekretari i KQV-së.

Vendi i trajnimit do të jetë sa më afër vendndodhjes së KZAZ-së, KQV-së.

Trajnimi i GNV-ve

Trajnimi i trajnuesve të GNV-ve

Programi i trajnimit me trajnuesit e GNV-ve (90 trajnues) do të zhvillohet në Tiranë. Trajnimi do të realizohet në një kohëzgjatje 2 ditore (2 grupe nga 1 ditë secili) sipas një skeme të grupimit të ZAZ sipas qarqeve.

Trajnimi i trajnimit të anëtarëve të GNV-ve

Trajnimi i anëtarëve të GNV-ve do të zhvillohet në 1 (një) ditë të vetme nga trajnuesit e GNV-ve. Programet e trajnimit, do të zhvillohen në sallat e mbledhjeve të organeve të qeverisjes vendore, prefekturave, nënprefekturave, qarqeve etj.

Zhvillimi i programit të trajnimit me anëtarët e GNV-ve, është i lidhur ngushtë me kohën e caktimit të tyre dhe prezencën e tyre në VNV, pra ky program trajnimi kryhet (menjëherë pas emërimit të tyre) 10 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Edhe në rastin kur do të kemi procedurën e zëvendësimit të grupeve të numërimit (para fillimit të numërimit apo edhe gjatë ditëve të numërimit), anëtarët e rinj të grupeve të numërimit do t'i nënshtrohen programit të trajnimit, që do zhvillohet në VNV-në përkatëse. Trajnimi mund të realizohet edhe nga trajnuesi rezervë, trajnuesi i KZAZ-së më të afërt, Sekretari/Kryetari i KZAZ-së).

Infrastruktura e trajnimit

Për transportimin e bazës materiale trajnuese në qarqe, në çdo njësi administrative, duhet të ndiqet eksperiencia pozitive e zgjedhjeve të mëparshme, që është realizuar nga ofrues shërbimi të kontraktuar nga KQZ-ja (Posta Shqiptare).

Bashkëpunimi i KQZ-së me institucione shtetërore dhe organizata të huaja për realizimin e trajnimeve:

1. Marrëveshje bashkëpunimi me MASH dhe MÇVendore, për:

- Ofrimin, vënien në dispozicion të objekteve shkollore, arsimore dhe social kulturore të DAR dhe zyrave arsimore të qarqeve përkatëse në funksion/dispozicion të realizimit të trajnimit sipas skemës së trajnimit;
- shfytëzimin e sallave të IT-së (komjuterat dhe vidio projektorët, nëse kanë) në shkollat, ku zhvillohet trajnim ;
- transportin e trajnuesve me mjetet e transportit të mësuesve, që janë në detyrë në zonat e largëta.

2. Marrëveshje bashkëpunimi (të kontraktuar) me Postën Shqiptare (*për transportimin e bazës materiale trajnuese*), komunikimin në linjë telefonike dhe elektronike për shkëmbimin e informacionit KQZ-KZAZ-trajnues-Inspektor rajonal dhe anasjelltas;

11. RISKU I PROJEKTIT

Për shkak të natyrës së tij, ky projekt paraqet disa rreziqe specifike:

1. Vonesat, që lindin si rezultat i propozimeve për anëtarë të komisioneve zgjedhore (KZAZ, KQV dhe GNV) nga partitë politike jashtë afateve kohore të emërimit të tyre ligjor, procedurë kjo e lidhur direkt me pjesëmarrjen e tyre në trajnimin e programuar në kohën e duhur.
2. Zëvendësimet e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të trajnuar me anëtarë të rinj një ditë para ditës së zgjedhjeve ose në ditën e zgjedhjeve.
3. Mospjesëmarrja në programet e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë, në ditën dhe orën e trajnimeve.
4. Mosidentifikimi i pjesëmarrësve në trajnim (anëtarë të KQV-ve dhe GNV-ve nuk nënshkruajnë në listën e pjesëmarrjesve, ky fenomen i konstatuar gjatë trajnimeve të kaluara).

12. BURIMET FINANCIARE

Për realizimin e këtij projekti do të planifikohen dhe përdoren burimet financiare nga buxheti i shtetit. Bashkëpunimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me organizmat ndërkombëtare kontribues dhe mbështetës për procesin zgjedhor ka qenë i vazhdueshëm dhe shumë i suksesshëm.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka patur mbështetjen dhe kontributin nëpërmjet asistencës teknike dhe donacioneve të ndryshme në zgjedhjet e mëparshme duke dhënë një ndihmë të çmuar në përmirësimin e metodologjisë e përdorur në përgatitjen e manualeve të trajnimit apo për ndërtimin e strukturës të sesioneve të trajnimit.

KQZ e çmon dhe konsideron të domosdoshëm bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtarë për përmirësimin cilësor të platformës së trajnimit, programeve të trajnimit në lidhje me materialet trajnuese dhe metodologjinë e dhënies së leksioneve, për të rritur efektivitetin e trajnimeve, në funksion të mirëadministrimit/menaxhimit të procesit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21 qershor 2015, në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare.

Donatorët, që do të ofrojnë ndihmë dhe do të mbulojnë shpenzimet e këtij projekti, mund ta japin atë në formën e burimeve logjistike apo burimeve financiare.

Kjo do të jetë për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një lehtësim real dhe i vlerësuar për të siguruar e garantuar stafin e nevojshëm teknik, bazën e nevojshme materiale dhe logjistike për realizimin e këtij projekti.

13. REFERENCË:

- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 23 Qershor 2013,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 8 maj 2011,
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 28 Qershor 2009
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, 18 Shkurt 2007.
- Raporti i OSCE/ODIHR për zgjedhjet për Kuvendin, 3 Korrik 2005.

**Strategjia e trajnimit të komisionerëve zgjedhorë,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qershor 2015**